

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Model i ri menaxhimi për Urgjencën Polivalente në QSUT, Spahiu: Synojmë rritjen e eficiencës
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/model-i-ri-menaxhimi-per-urgjencen-polivalente-ne-qsut-spahiu-synojme-rr-i588485
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 08:24:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 10:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	636533ded2678a54d05da9aeceea6c36ad0fa8e894edc78fb021c6c176523fee
TEKSTI	98ccc8d5557938d5683ede5ea64657571317d725f2da0d07cf1826aee00d1f80
PAMJA	93eede4533de76bd74c4e1ce675be8d2d64faaf693c51e16c3e2a44a1ff82b70

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c4f2383f0cf363376ad961a526c3a83fcd5420e553296a7f97cdd44ae2309568
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aeabf4509e171eed592273ece5cddf4aeb2f22a188459bccfd99accd67acf91
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c4f2383f0cf363376ad961a526c3a83fcd5420e553296a7f97cdd44ae2309568>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

Po hynte ne Shqiperi, arrestohet sapo zbret nga avioni ukrainasi i kerkuar per trahk droge dhe organizate kriminale/Kina dhe SHBA-ja bien dakord te pasurojne permbaj fundit

Model i ri menaxhimi për Urgjencën Polivalente në QSUT, Spahiu: Synojmë rritjen e eficiencës



26 Shtator 2026, 12:10Sociale TEMA



Në Urgjencën Polivalente të QSUT-së po zbatohet një model i ri menaxhimi dhe funksionimi, me synim rritjen e eficiencës, koordinimit të ekipeve dhe përgjigjes në kohë ndaj pacientëve.

Si porta e parë për rastet që kërkojnë kujdes të menjëhershëm, kjo strukturë ka ofruar shërbim për rreth 91 mijë pacientë vetëm gjatë periudhës janar–shtator 2026.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Klodiana Spahiu, gjatë inspektimit të punimeve, u shpreh se organizimi i ri i proceseve dhe triazhimi i domosdoshëm do të lehtësojnë fluksin e pacientëve dhe do të rrisin performancën e urgjencës.

“Më vjen mirë që në një kohë të shkurtër keni arritur ta organizoni punën. Përveç faktit që duhet të lehtësojmë shërbimin dhe të kemi triazhimin që është i domosdoshëm, duhet të ndërgjegjësojmë më shumë qytetarët që rastet që nuk janë urgjente të zgjidhen nga mjeku i familjes. Nëse triazhimi bëhet siç duhet dhe kemi koordinim me spitalet rajonale për rastet që nisen drejt qendrës terciare, atëherë do të arrijmë objektivin tonë për të pasur performancë sa më të mirë në Urgjencën e QSUT-së.”

Ajo theksoi rëndësinë e ndërgjegjësimin të qytetarëve që rastet jo emergjente të trajtohen nga mjeku i familjes, si dhe koordinimin me spitalet rajonale për menaxhimin e rasteve drejt qendrës terciare.

Drejtoresha e QSUT-së, Rudina Degjoni, deklaroi se kjo është urgjenca e rikonceptuar për t'i dhënë më shumë hapësirë dhe lehtësi pacientëve. Në këtë strukturë, pacientëve u bëhet triazhi i parë dhe kalimi sipas kodeve të urgjencës: i bardhë, i verdhë dhe i kuq, në varësi të gjendjes shëndetësore.

“Kjo është urgjenca që e kemi rikonceptuar për t'i dhënë më shumë lehtësi pacientëve dhe më shumë hapësirë. Në këtë vend pacientit do t'i bëhet triazhi i parë dhe kalimi sipas kodit; kodi i bardhë, kodi i verdhë dhe kodi i kuq, në pjesën e observimit.”

Sipas saj ky model i ri synon jo vetëm përmirësimin e cilësisë së shërbimit, por edhe krijimin e një sistemi më efikas e të koordinuar për menaxhimin e rasteve emergjente në QSUT.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Ambasadorja e BE-së në Shqipëri takim me ministren Pirdeni: Rikonfirmojmë angazhimin e plotë të BE-së për të mbështetur Shqipërinë](#)

20:25 Sociale

20 vite UET/ Nga një ide, në një histori që vazhdon

20:20 Sociale

VKM/ Qeveria përfshin Fondin Shqiptar të Zhvillimit në projektet e reja të rindërtimit në Kombinat

18:25 Sociale / 1 koment

[Nyerimihet karrua e New York. Aeroporti ndërkombëtar i Tiranës, dëshirë transformimi të Shqipërisë](#)

17:54 Sociale / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.